

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Nr.10

Nëntor 2021



NUK KA PAVARËSI GJYQËSORE PA DEMOKRACI DHE NUK KA DEMOKRACI PA PAVARËSI GJYQËSORE

Më 10 Nëntor 2021, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese znj. Vitore Tusha, zv. Kryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahim, Prokurori i Përgjithshëm z. Olsian Çela, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Drejtori i Shkollës së Magjistratutës z. Arben Rakipi, zhvilluan një vizitë pune në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg dhe në Gjykatën Kushtetuese Federale të Gjermanisë, si pjesë e një programi dialogu për përfaqësues të lartë të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, organizuar nga Fondacioni Konrad Adenauer.

Në një sesion të posaçëm me gjyqtarët

e zgjedhur në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut, Inspektori i Lartë Artur Metani mbajti një fjalë me temë “Pavarësia dhe Paanësia e Gjyqtarëve”, e parë në përgjithësi dhe nga këndvështrimi i hetimit e procedimit disiplinor.

Duke u ndalur tek rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së magistratëve që është mospërgjegjësia për vendimet e dhëna sipas bindjes së tyre, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vërejt se duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur përgjegjës magistratët, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve që justifikojnë këtë veprim.

“Kjo sepse pavarësia nuk është privilegj, por është përgjegjësi. (Vijon)



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Gjatë konferencës

“Pavarësia e gjyqësorit ka dy komponentë realë të saj që janë: paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit dhe e gjykatës. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve.

Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet.

Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim (Kyprianou k. Qipros; Micallef k. Maltës; Piersack k. Belgjikës; Grieves k. Mbretërisë së Bashkuar; Auschildt k. Danimarkës).”, tha z. Metani

Në rastin konkret duhet të ekzistojë një proces i vazhdueshëm i balancimit të pavarësisë dhe llogaridhënies. Këto procese duhet të karakterizohen nga veprimi dhe kundër reagimi në të njëjtën kohë. Sa më shumë kompetenca të zotërojnë pushteti gjyqësor, aq më të larta duhet të jenë kërkesat për llogaridhënie. Pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk mund të garantohet nëse nga ana e një shoqërie apo sistemi politik nuk ka vullnet për krijimin e një fryme stabiliteti dhe demokracie. Pavarësia e pushtetit gjyqësor kërkon përfundimisht një kontekst dhe mentalitet jo autoritar. Përfundimi se “Nuk ka pavarësi gjyqësore pa demokraci dhe nuk ka demokraci pa pavarësi gjyqësore” mund të jetë zhgënjyes në pamje të parë, por ky përfundim argumenton qartë se demokracia dhe sundimi i ligjit janë të lidhura

bashkë.”, u shpreh Inspektori i Lartë Metani

Pavarësia e gjyqësorit, masat për uljen e numrit të çështjeve në gjykata dhe çështje të praktikës gjyqësore të GJEDNJ, lidhur me Shqipërinë u diskutuan mes delegacionit të lartë shqiptar dhe gjyqtarëve të GJEDNJ, z.Georges Ravarani, kryetar seksioni, gjyqtar i zgjedhur për Luksemburgun, z.Georgios Serghides, zëvendëskryetar seksioni, gjyqtar i zgjedhur për Qipron, z. Dmitry Dedov, gjyqtar i zgjedhur për Federatën Ruse, znj. María Elósegui, gjyqtare e zgjedhur për Spanjën, z. Darian Pavli, gjyqtar i zgjedhur për Shqipërinë, znj. Anja Seibert-Fohr, gjyqtare e zgjedhur për Gjermaninë, z. Peeter Roosma, gjyqtar i zgjedhur për Estoninë, z. Andreas Zünd, gjyqtar i zgjedhur për Zvicrën dhe z. Frédéric Krenc, gjyqtar i zgjedhur për Belgjikën.

FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË ARTUR METANI ME TEMË “PAVARËSIA DHE PAANËSIA E GJYQTARËVE” NË GJEDNJ



Diskutimi im në këtë panel të nderuar pjesëmarrësish ka për qëllim të ngrejë paraprakisht disa teza, me qëllim provokimin e mendimit, pse jo dhe debatit, të cilat në këndvështrimin tim janë konceptuale dhe sistemike lidhur me një sërë çështjesh të cilat kanë të bëjnë pavarësinë, paanësinë apo llogaridhënien e magjistratëve.

Pavarësia e gjyqtarëve dhe gjykatave është një nga parimet themelore të shtetit demokratik. Pavarësia është një parakusht i sundimit të ligjit. Si e tillë, pavarësia e gjyqësorit mbështet shtetin e së drejtës dhe është thelbësore për funksionimin e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Ndërsa vendet në tranzicion nga autoritarizmi në demokraci

duhet të përballen me një “ndikim” agresiv të pushtetit ekzekutiv apo atij legjislativ ndaj pushtetit gjyqësor, kërkimi dhe aplikimi i mekanizmave të nevojshme për të mbrojtur pavarësinë e sistemit gjyqësor, mbetet ende sfidë, edhe në vendet me demokraci të zhvilluar.

Ekziston një prirje e rëndësishme për të siguruar pavarësinë e pushtetit gjyqësor me rrugë të garancive formale dhe procedurave fikse. Edhe pse është e rëndësishme të pranojmë, që sistemet gjyqësore në vende të ndryshme kanë pasur evoluim apo rrugëtime të ndryshme të konsolidimit të tyre, funksionet që kryejnë, mënyra e ushtrimit të këtyre funksioneve, organizimet strukturale, si dhe një sërë konceptesh, të cilat kanë të bëjnë me “pavarësinë substanciale”, apo “pavarësinë strukturore” janë çështje dhe sfida të përbashkëta të të gjitha vendeve. Megjithatë është i diskutueshëm fakti, nëse duhet të aplikohet një standard ndërkombëtar uniform.

Ekzistojnë një sërë aktesh juridike me karakter ndërkombëtar të cilat synojnë të garantojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, si Neni 14 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Neni 8 i Konventës Amerikane mbi të Drejtat e Njeriut, Neni 26 i Kartës Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve, si dhe një sërë aktesh juridike (soft law), me karakter rekomandues apo opinione.



Këto të parime apo të drejta janë ligjërisht të detyrueshme për shtet palë, të cilët marrin pjesë në këto akte me karakter ndërkombëtar. Megjithatë, shtetet priren të përshtatin dhe të ndryshojnë mënyrën e zbatimit të tyre. Kjo nuk është për të mohuar vlefshmërinë e këtyre parimeve apo të drejtave, por për të theksuar se mënyra e aplikimit të tyre, në një vend të caktuar përkon me kontekstin historik, social, politik apo ligjor të atij vendi.

Në këtë kontekst, edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) nëpërmjet jurisprudencës së saj, i ka lënë hapësirë vlerësimi shteteve anëtare, si të organizojnë pushtetin gjyqësor për sa kohë kjo formë organizmi dhe funksionimi ofron garancitë formale, që mbrojtë magjistratët nga ndërhyrjet në procese gjyqësore (Belilos v. Switzerland,; Campbell and Fell v. The United Kingdom; Sramek v. Austria,; Ninn-Hansen v. Denmark; Filippini v. San Marino,). Ndonëse nocioni i ndarjes së pushteteve ka marrë një rëndësi përherë e më të madhe në jurisprudencën e GJEDNJ, përsëri normat e Konventës por edhe jurisprudenca e GJEDNJ, nuk i detyron shtetet, që të përshtaten me nocione strikte të karakterit teorik kushtetues, lidhur mënyrën e zgjedhur apo ndërveprimin midis organeve të pushtetit. Çështja qëndron nëse kanë përmbushur ose jo kërkesat e Konventës, sipas interpretimit autonom të nocioneve të nenit 6 të K.E.D.NJ. (Henryk Urban e Ryszard Urban k. Polonisë, § 46).

Në mënyrë për të shqyrtuar më afër çështjet e pavarësisë duhet të referohemi dhe të konsiderojmë gjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Campbell dhe Fell v Mbretërisë së Bashkuar dhe Incal v Turqisë,

apo Findlay k. Mbretërisë së Bashkuar, ku Gjykata sanksionojë kërkesat e “pavarësisë”, në të cilat përfshihen: (i) mënyra e emërimit të gjykatësve; (ii) kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të tij; (iii) ekzistenca e një mbrojtjeje kundër trysnive të jashtme, (iv) nëse duket apo jo i pavarur nga pamja e jashtme.

Në të njëjtën kohë, GJEDNJ nëpërmjet jurisprudencës së saj ka elaboruar një sërë çështjesh, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e paanësisë së gjykatës, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, sipas kërkesave të nenit 6 të KEDNJ.

Pavarësia e gjyqësorit ka dy komponentë realë të saj që janë: paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit dhe e gjykatës. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët, në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë, që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet. Respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin subjektiv, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes apo interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin objektiv, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim (Kyprianou k. Qipro; Micallef k. Maltës; Piersack k. Belgjikës; Grieves k. Mbretërisë së Bashkuar; Auschildt k. Danimarkës).

Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së magjistratëve është mospërgjegjësia për vendimet që japin sipas bindjes së tyre, mbështetur në ligj. Megjithatë, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria i jep magjistratëve është e tillë, që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur përgjegjës, përfshi edhe largimin nga detyra, në rast të shkeljeve, që justifikojnë këtë veprim. Duhet pranuar, se rritja e kompetencës dhe pavarësisë së magjistratëve duhet të shoqërohet me një sistem llogaridhënës efektiv.

Për këtë qëllim, është e nevojshme që organet e qeverisjes së gjyqësorit të kenë një qasje aktive ndaj sistemit llogaridhënës të magjistratëve duke aplikuar qasje të reja, të cilat konsistojnë në aplikimin në mënyrë të kombinuar e standardeve të përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së tyre. Kur i referohemi konceptit të "përgjegjshmërisë së magjistratëve", duhet të mbajmë në konsideratë faktin, se ky koncept është i ndryshëm nga ai i "përgjegjësisë" së tyre, koncepte të cilat, të dyja bashkë përbëjnë sistemin "llogaridhënës", të magjistratëve.

Sistemi llogaridhënës i magjistratëve nuk duhet të keqpërdoret nga ana e organeve të tjera të pushtetit, me qëllim kontrollin dhe cenimin pavarësisë gjyqësore. Sistemi llogaridhënës duhet të udhëhiqet pikësisht nga nocioni i përgjegjshmërisë së magjistratëve, si një mekanizëm parandalues dhe që siguron ndërtimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm.

Kjo duhet të realizohet nëpërmjet aplikimit të politikave apo masave të cilat synojnë: (i) rekrutimin apo përzgjedhjen e magjistratëve mbi bazë të meritave; (ii) kualifikimin profesional të tyre; (iii) palëvizshmërinë nga detyra; (iv) pavarësinë substanciale; (v) pavarësinë strukturore dhe financiare; (v) imunitetin dhe integritetin fizik; (vi) ushtrimin e një kontrolli nga ana e gjykatave më larta në bazë të parimeve të pavarësisë së brendshme të magjistratëve, si dhe ushtrimi i një kontrolli jo formal ndërmjet jurisprudencës ndërkombëtare apo doktrinës juridike.

Në rast se këto mjete nuk rezultojnë efektive, atëherë në raste përjashtimore, si dhe në varësi të rrethanave të caktuara mund të aplikohen masat mbi përgjegjësinë penale, civile apo disiplinore të tyre, si dhe gjithmonë në kuadër të një procesi të rregullt ligjor.

Kjo sepse pavarësia nuk është privilegj, por është përgjegjësi. Në rastin konkret duhet të ekzistojë një proces i vazhdueshëm i balancimit të pavarësisë dhe llogaridhënies. Këto procese duhet të karakterizohen nga veprimi dhe kundër reagimi në të njëjtën kohë. Sa më shumë kompetenca të zotërojë pushteti gjyqësor, aq më të larta duhet të jenë kërkesat për llogaridhënie.

Procesi llogaridhënës përbën në vetvete një marrëdhënie

(dhënie llogarie) ndërmjet individëve. Në këtë kuadër, një magjistrat nuk duhet të jetë përgjegjës vetëm respektimin apo jo të normave ligjore, por edhe ndaj njerëzve, shoqërisë si dhe organeve të pushtetit shtetëror. Duke ndikuar kështu, në mënyrë të drejtpërdrejtë në perceptimin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Besimi i publikut nuk është nocion i papërkufizuar, por ai gjen mbështetje te vlerat themelore dhe standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së magjistratëve. Nëse magjistratët nuk e përmbushin plotësisht rolin e tyre për dhënien e sigurimit e drejtësisë në shoqëri ekziston rreziku i humbjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në organet e drejtësisë është element mjaft i rëndësishëm për sistemin e drejtësisë.

Për të ndërtuar besueshmëri patjetër duhet siguruar një kulturë llogaridhënie e sistemit të drejtësisë. Në demokraci drejtësia jepet në emër të qytetarëve. Besimi i publikut është i domosdoshëm për sundimin e ligjit dhe ky legjitimim kërkon angazhimin e magjistratëve për të ruajtur këtë besim. Në këtë kuadër, vlen të theksohet se pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk duhet të shihet si një privilegj i magjistratëve, por si një e drejtë e qytetarëve.

Niveli i besueshmërisë së qytetarëve në gjyqësor është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar se si funksionon sistemi i drejtësisë dhe sundimi i ligjit në një vend. Në të njëjtën kohë, besimi i publikut shërben si tregues i rëndësishëm mbi balancën që duhet të ekzistojë ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies së pushtetit gjyqësor. Në rastet kur besimi i publikut është i ulët, atëherë tregon se pavarësia e magjistratëve ka prevaluar mbi sistemin llogaridhënës, ndërsa në rast se besimi i publikut është i lartë, atëherë ky është një tregues i qartë mbi ekzistencën e një ekuilibri të drejtë ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies.

Megjithatë, në mbyllje të kësaj fjale më duhet të theksoj se garantimi i pavarësisë së pushtetit gjyqësor kërkon kohë dhe kërkon përpjekje të vazhdueshme. Ndërsa ndërtimi i institucioneve është një aspekt i sundimit të ligjit, sukcesi i tij varet përfundimisht nga vullneti politik, mentaliteti dhe stadi i zhvillimit të shoqërisë së një vendi.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk mund të garantohet nëse nga ana e një shoqërie apo sistemi politik nuk ka vullnet për krijimin e një fryme stabiliteti dhe demokracie. Pavarësia e pushtetit gjyqësor kërkon përfundimisht një kontekst dhe mentalitet jo autoritar. Përfundimi se "Nuk ka pavarësi gjyqësore pa demokraci dhe nuk ka demokraci pa pavarësi

gjqësore” mund të jetë zhgënjyes në pamje të parë, por ky përfundim argumenton qartë se demokracia dhe sundimi i ligjit janë të lidhura bashkë.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor mund të shoqërohet me ndryshime strukturore, institucionale dhe ligjore, por ajo mund të ketë sukses vetëm kur shoqëria e një vendi të ketë besim në legjitimin e pushtetit gjyqësor dhe të tregojë një përkushtim real ndaj këtij standardi. Edhe pse aktorët ndërkombëtarë mund të luajnë një rol mbështetës në këtë proces zhvillimi ata nuk mund të kompensojnë mungesën e iniciativës së brendshme së një vendi.

Mënyra se si garantohet pavarësia e gjyqësorit varet nga kultura gjyqësore e një vendi, e cila pasqyron përvojat e tij të veçanta historike, në raport me rrethanat politike apo sociale. Masat e veçanta të cilat janë miratuar apo përshtatur në një vend të caktuar me qëllim sigurimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, të cilat mund të ketë të bëjnë me rekrutimin dhe karrierën e magistratëve, qëndrimin në detyrë apo mandatin, imunitetin, pagat, përgjegjësinë disiplinore, civile apo

penale, pavarësinë substanciale apo strukturore, trajnimin apo sigurinë fizike, nuk janë domosdoshmërisht një tregues i garantimit të standardit të pavarësisë së gjyqësorit, pasi këto masa mund të aplikohen dhe të japin rezultate të ndryshme në varësi të kontestit ligjor, politik dhe social të çdo vendi.

Procesi i sigurimit të pavarësisë dhe paanësisë së magistratëve është një proces dinamik dhe në evoluim të vazhdueshëm. Sigurimi i kësaj pavarësie kërkon një nevojë të vazhdueshme për t’u përgjigjur sfidave për identifikimin e mekanizmave të rinj të mbrojtjes së këtij standardi. Çdo model mbi ndërtimin dhe aplikimin e standardit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor është i ndryshëm dhe duhet kuptuar si rezultat i zhvillimeve të ndryshme historike në një vend të caktuar. Ky qëllim arrihet nëpërmjet një procesi ndryshimi, i cili duhet t’i përgjigjet kërkesave publike dhe sfidave të reja nëpërmjet modifikimit gradual të traditave të një vendi.

Faleminderit!

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PËRFUNDOI VIZITËN NË DISA INSTITUCIONE EUROPIANE TË DREJTËSISË



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani bashkë me drejtues të institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri, përfundoi një vizitë pune në institucionet më të larta të drejtësisë në Gjermani dhe në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, për të parë nga afër sistemin gjerman të drejtësisë, si dhe atë të GJEDNJ.

Gjatë vizitës në Gjykatën Kushtetuese Federale në Karlsruhe delegacioni i lartë shqiptar bashkëbisedoi me zv. Presidenten e kësaj Gjykate Prof. Dr. Doris King dhe gjyqtaren kushtetuese federale Dr. Sibylle Kessal-Ëulf mbi funksionin e Gjykatës Kushtetuese Federale në një vend demokratik të shtetit të së drejtës.



Gjatë vizitës në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Starsburg, në një sesion të posaçëm me anëtarë të kësaj Gjykate, Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbajti një fjalë me temë “Pavarësia dhe Paanësia e Gjyqtarëve”, e parë në përgjithësi dhe nga këndvështrimi i hetimit e procedimit disiplinor. Inspektori i Lartë Artur Metani nënvizoi se nuk ka pavarësi gjyqësore pa demokraci dhe nuk ka demokraci pa pavarësi gjyqësore, kjo pasi demokracia dhe sundimi i ligjit janë të lidhura bashkë.

Reforma në Drejtësi dhe Shqipëri ishte në fokus të bashkëbisedimit në takim me deputetin e Bundestagut, anëtar i komisionit të Ligjeve dhe i çështjeve europiane Dr. Volker Ulrich. Duke folur për punën e institucioneve të drejtësisë, z. Metani tha se reforma në drejtësi nuk mund të ketë sukses pa demokratizimin e shoqërisë shqiptare. Dhe mënyra më e mirë për këtë është integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.


Kjo vizitë e delegacionit të lartë të drejtuesve të institucioneve shqiptare të drejtësisë, në përbërje të të cilit ishin Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese znj. Vitore Tusha, zv. Kryetari i Gjykatës së Lartë z. Sokol Sadushi, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Naureda Llagami, Kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë z. Gent Ibrahim, Prokurori i Përgjithshëm z. Olsian Çela, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca dhe Drejtori i Shkollës së Magjistratutës z. Arben Rakipi u organizua nga fondacioni Konrad Adenauer.



KLP PRANON KËRKESËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATES O.T.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi propozimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates O.T. me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Hetimi disiplinor i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka nisur me iniciativë pas indicjes së paraqitur pranë ILD nga emisioni investigativ “Stop”, në TV Klan, si dhe bazuar në të dhënat e marra nga verifikimi i kryer. Emisioni investigativ transmetoi rastin e vrasjes së një 18 vjeçari dhe pretendimin e familjarëve se prokurorja ka zvarritur çështjen. Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, u konstatua se magjistratja ka zvarritur në mënyrë të pajustificuar veprimet dhe aktet

procedurale lidhur me rastin, duke mos ndërmarrë veprimet përkatëse, në njoftimin e familjarëve të viktimës për të drejtat që u njeh ligji, si dhe ka vonuar pa shkak dërgimin e çështjes në gjykatë. Kjo vonesë është bërë tej afatit të arsyeshëm, për një periudhë mbi 6 muaj dhe parashikohet, si shkelje disiplinore (neni 102 pika 1 shkronja “d” e ligjit me nr.96/2016), dhe veprimet e mosveprimet e magjistrates kanë sjellë pasoja për dhënien e drejtësisë, cënimin e prestigjit të prokurorit, si dhe kanë cënuar besimin e publikut te drejtësia.



AVOKATJA E POPULLIT VLERËSON ROLIN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në datën 19 Nentor Inspektori i Lartë i Drejtësisë priti në një takim pune Avokatën e Popullit znj. Erinda Ballanca. Dy drejtuesit e lartë biseduan mbi ecurinë e bashkëpunimit mes institucioneve, lidhur me ankesat e qytetarëve ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Z. Metani u shpreh i kënaqur nga bashkëpunimi me institucionin e Avokatit të Popullit dhe shprehu vullnetin për forcimin e tij, në funksion të detyrave respektive që u ngarkon ligji, me vëmendje të posaçme në balancimin e parimeve të interesit publik për administrimin e drejtësisë, respektimit të të drejtave të individëve, parimit të ligjshmërisë, gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, si dhe atij të ndarjes së pushteteve.

Avokatja e Popullit znj. Ballanca vlerësoi rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të garantuar zbatimin korrekt të ligjit nga të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë. Ajo vlerësoi edhe transparencën e komunikimit me qytetarët e publikun mbi punën e ILD-së, si dhe efektivitetin në trajtimin e një numri të konsiderueshëm ankesash ndaj magjistratëve, megjithë vështirësitë infrastrukturore e në burime njerëzore. “Nevoja e institucioneve të reja të sistemit të drejtësisë për të patur kapacitete të



përshtatshme për të ushtruar me sukses detyrat e tyre, ka qenë pjesë e rekomandimeve të Avokatit të Popullit në raportet vjetore që i paraqiten kuvendit”, u shpreh znj. Ballanca.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Avokatja e Popullit bashkëndanë mendimin se kthimi i besimit të publikut tek drejtësia duhet të jetë prioritet i çdo institucioni në vend.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, Z. METANI PRITI HOMOLOGË NGA INSPEKTORATET E RUMANISË, PORTUGALISË E FRANCËS

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani priti në një vizitë zyrtare, në datën 22 Nëntor, homologë nga Inspektoratet e Drejtësisë të Rumanisë, Portugalisë e Francës, anëtarë të Rrjetit European të Inspektimit, mbështetur nga projekti i Këshillit të Evropës SEJ III, që ka në fokus mbështetjen e institucioneve të reja të drejtësisë në Shqipëri të krijuara me reformën në drejtësi. Inspektimi, si një praktikë e re, ishte në fokus të takimit me kreun e Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, gjykatësin Lucian Netejoru, me inspektorin gjykatës Luis Jardim nga Inspektorati i Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor në Portugali dhe inspektoren znj. Martine Bardet nga Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë së Francës. Z. Metani tha se ILD është institucion i ri, që me gjithë mungesat në burime njerëzore, po përpiqet të ndërtojë një eksperiencë me praktikën më të mira të inspektimit. Prandaj komunikimi e bashkëpunimi me institucionet homologe europiane është shumë i rëndësishëm.

“Filozofia e ILD-së, tha z. Metani është se për inspektimin, duhet gjetur balanca e duhur ndërmjet interesit të publikut për punën e magjistratëve dhe pavarësisë së gjyqtarëve e prokurorëve. Kjo filozofi e punës së institucionit rrjedh nga debatet më të mira me personalitete të fushës së drejtësisë por edhe kolegë të huaj.” Z. Netejoru, z. Jardim dhe znj. Bardet bënë një paraqitje të modelit të inspektimit në vendet respektive dhe u shprehën të gatshëm të ndajnë eksperiencat me zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kreu i Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, gjykatës Lucian Netejoru tha se edhe Rumania që ka një model krejt të pavarur të inspektimit, e ka eksperiencë të re, të nisur në vitin 2012 dhe për këtë komunikimet me homologët e vendeve të tjera janë të nevojshme. Pas takimit, të shoqëruar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, tre të ftuarit zhvilluan një vizitë pune në Vlorë, në Gjykatën e Rrethit. Ndërsa në dy ditët e mëpasme të vizitës



zyrtare në Shqipëri janë parashikuar takime në Kuvendin e Shqipërisë (23 Nëntor) dhe në KLGJ, KLP e Shkollën e Magjistraturës (24 Nëntor).

Pjesë e rëndësishme e kësaj vizite zyrtare është trajnimi dy ditor, që zhvillohet në hotel Tirana ku inspektorë magjistratë nga Franca, Italia e Rumania do të flasin mbi praktikën më të mira të inspektimit gjyqësor nga Inspektoriatet Europiane të Drejtësisë, me inspektorët, ndihmës inspektorët dhe anëtarë të kabinetit të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.



ANKIMIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al
- ⇒ ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- ⇒ Mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.



Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj. Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD-së www.ild.al, në seksionin “Si pranoen ankesat”.

“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”

STATISTIKA

Gjatë muajit **Nëntor**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **98 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione. Është bërë konfirmimi standart i marrjes së ankesave dhe janë shpërndarë sipas siglimit të inspektori përgjegjës.

Konkretisht:

81 ankesa janë depozituar nga qytetarët;

17 ankesa janë përcjellë nga institucione dhe organizata për kompetencë;

38 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

17 takime me ankues.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Nëntor 2021.



Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.



Pas takimit me homologë nga Inspektorate europiane të Drejtësisë, konkretisht kreu i Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, gjykatësi Lucian Netejoru; inspektori magjistrat Luis Jardim i Inspektoratit të Drejtësisë së Portugalisë dhe inspektorja magjistrate znj. Martine Bardet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani i është përgjigjur pyetjeve të gazetares Anila Hoxha të Top Channel, mes të tjerash edhe për natyrën e ankesave të qytetarëve pranë ILD.

“Ankesat më të shumta janë për sa i përket zgjatjes së proceseve gjyqësore, padrejtësive që qytetarët mendojnë se janë bërë nga gjykatat, nga gjyqtarët apo edhe nga prokurorët në vlerësim të zgjidhjes ligjore, që i është dhënë çështjeve të tyre; civile apo penale kryesisht”, tha z. Metani duke shtuar se *“do fokusohemi që t’i përgjigjemi në një periudhë sa më të shkurtër të gjitha ankesave që qytetarët bëjnë, por kjo sigurisht varet edhe nga burimet njerëzore.”*

I pyetur për pjesën më të vështirë në këtë moment të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, z. Metani nënvizoi se vetë puna e ILD synon edhe garantimin e pavarësisë së magjistratëve, si një garanci për të drejtat e qytetarëve.

“Unë mendoj që sfidat sa i përket burimeve njerëzore dhe infrastrukturës ligjore e kështu me radhë janë gjëra që gjejnë zgjidhje në një moment apo në një tjetër, si tani apo pak me vonë. Ajo që është e rëndësishme për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe për qytetarët në përgjithësi është vendosja e standardeve më të mira për sa i përket kësaj balancës, të cilës iu referova në fillim. Gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë, por nga ana tjetër edhe pavarësisë së gjyqtarëve, që nuk është një pavarësi që i përket gjyqtarëve por edhe një e drejtë që i përket qytetarëve. Sa më i pavarur të jetë gjyqtari, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e tij. Dhe kjo është ajo që ne duhet të arrijmë.”, tha z. Metani

METANI: SA MË I PAVARUR TË JETË GJYQTARI, AQ MË I GARANTUAR ËSHTË QYTETARI

Pyetjeve të gazetares Anila Hoxha i është përgjigjur edhe kreu i Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, gjykatësi Lucian Netejoru.

Komunikimi i plotë:

Anila Hoxha, Top Channel: Mendova të pyes zotërinë e Rumanisë duke qenë se kanë pavarësinë totale dhe modelin që po i ofrojnë Shqipërisë në këtë kuadër trajnimit.

Kreu i Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, Lucian Netejoru: Përhëndetje, kënaqësi që ju takova në Shqipëri. Jam shumë i lumtur që u ftova nga kolegët tanë shqiptarë për të qenë këtu dhe sigurisht me mbështetjen e Këshillit të Evropës.

Anila Hoxha, Top Channel: Ju jeni institucion i konsoliduar në vendin tuaj dhe natyrisht që keni një pavarësi totale dhe kjo ju sjell rezultate më të larta në kontrollin e sistemit. Çfarë duhet të mbajë parasysh Shqipëria, sa kohë ju ndërkohë keni sjellë edhe inspektorë që do të trajnojnë kolegët e tyre në Shqipëri?

Kreu i Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë, Lucian Netejoru: Inspektori i Lartë i Drejtësisë në Rumani është një organ i pavarur. Me këtë nënkuptoj institucionet si Gjykata e Lartë, magjistratura si dhe parlamenti rumun. Ne nuk kemi një eksperiencë kaq të gjatë, -vetëm prej 2012-ës-, ne jemi krejtësisht të pavarur, pasi bëmë disa ndryshime në organizim në vitin 2018. Por jemi vërtetë të pavarur sa i përket hetimeve disiplinore, verifikimeve dhe inspektimeve, që lidhen me ato tematike dhe të përgjithshme. Ne jemi zotuar të ndajmë të gjithë eksperiencën tonë me kolegët shqiptarë, në mënyrë që të përmirësojnë aktivitetin e tyre dhe të forcojnë kapacitetet e tyre, kapacitetet administrative sepse janë në fillimet e tyre në këtë aktivitet dhe në opinionin tonë është e nevojshme të mësojnë të jenë të pavarur. Jam shumë i sigurt se kolegët shqiptarë do të mësojnë se çdo të thotë të jesh i pavarur dhe të mirat që ka të qenit i pavarur. Së pari për vetë sistemin gjyqësor dhe më pas për qytetarët. Edhe pse targeti jonë është sistemi i drejtësisë, besimi i publikut është po ashtu i rëndësishëm. Kjo sepse ata janë të parët që pretendojnë drejtësi dhe sepse sjelljen jo të mirë të gjyqtarëve apo të shërbimeve nëpër gjykata, qytetarët e ndiejnë të parët.

Anila Hoxha, Top Channel: Z Metani një pyetje të shkurtër. Ju gjatë funksionimit tuaj si institucion, praktikisht i ri, keni shënuar, dhe ka një eksperiencë shumë pozitive, sa i takon

qëmtimit të rasteve të paduhura që qëndrojnë në prokurori apo edhe në gjyqësor. Megjithatë, a ka ardhur koha vërtetë, që jo vetëm të mësohet si të jenë të pavarur inspektorët por gjithashtu të ketë edhe një rishikim të kuadrit ligjor, në mënyrë që të jeni totalisht të pavarur dhe nën modelin e kolegut tuaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Së pari, më lejoni të falënderoj kolegët që kanë ardhur nga Rumania, Franca dhe Portugalia në kuadër të një vizite të organizuar nga Këshilli i Evropës për të asistuar funksionimin më të mirë të institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është një zyrë e re dhe sigurisht kompetencat janë të reja, kërkojnë një mentalitet të ri të funksionimit dhe ushtrimit të këtyre kompetencave dhe modelet më të mira që vijnë nga demokracitë e zhvilluara janë mënyra më e mirë, që këtë mentalitet të ri ta krijojmë dhe ta ushtrojmë edhe në Shqipëri. Sa i përket pavarësisë së mëtejshme të institucioneve, unë mendoj që ne e kemi kuadrin kushtetues dhe ligjor, që organizon funksionimin e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Është ende herët për të diskutuar për gjëra të tilla sepse ne jemi në kuadrin e konsolidimit të praktikave tona të para, kështu që ky është interesi ynë i parë tashmë, edhe për të diskutuar me kolegët. Të shohim si ecën puna, si krijohet ky mentalitet i ri dhe kjo filozofi e re me gjetjen e asaj balance të duhur ndërmjet interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Kjo është ajo që ne kërkojmë të arrijmë dhe që do të diskutojmë me kolegët sot, gjithmonë e në vijim.

Anila Hoxha, Top Channel: Sapo morët stafetën si drejtues i ILD ju konstatuat dhe deklaruat se keni gjetur gati 900 ankesa të qytetarëve shqiptarë që pretendonin shkelje ligjore, qoftë nga gjyqtarët por edhe prokurorët. Kryesisht për çfarë ankoheshin qytetarët shqiptarë dhe për çfarë vazhdojnë të ankohen?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Ky numër ka ndryshuar. Tashmë shkon tek 4500 ankesa mesatarisht. Ne jemi munduar t'i përgjigjemi interesit të qytetarëve me përgjigjen e ankesave. Kemi trajtuar rreth 1500, edhe pse me burime njerëzore të kufizuara. Megjithatë, për t'iu fokusuar pyetjes suaj, ankesat më të shumta janë për sa i përket zgjatjes së proceseve gjyqësore, padrejtësi që qytetarët mendojnë se janë bërë nga gjykatat, nga gjyqtarët apo edhe nga prokurorët në vlerësim të zgjidhjes ligjore, që i është dhënë çështjeve të tyre; civile apo penale kryesisht, dhe do fokusohemi që t'i përgjigjemi në një periudhë sa më të shkurtër të gjitha ankesave që qytetarët bëjnë, por kjo sigurisht varet edhe nga burimet njerëzore.

Anila Hoxha, Top Channel: Cila është pjesa më e vështirë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për momentin, me të cilën ju po ndesheni dhe e keni gati-gati si sfidë?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani: Unë mendoj që sfidat sa i përket burimeve njerëzore dhe infrastrukturës ligjore e kështu me radhë janë gjëra që gjejnë zgjidhje në një moment apo në një tjetër, si tani apo pak më vonë. Ajo që është e rëndësishme për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe për qytetarët në përgjithësi është vendosja e standardeve më të mira për sa i përket kësaj balancës, të cilën iu referova në fillim. Gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë, por nga ana tjetër edhe pavarësisë së gjyqtarëve, që nuk është një pavarësi që i përket gjyqtarëve por edhe një e drejtë që i përket qytetarëve. Sa më i pavarur të jetë gjyqtari, aq më i garantuar është qytetari për të drejtat e tij. Dhe kjo është ajo që ne duhet të arrijmë.





PRAKTIKAT MË TË MIRA EUROPIANE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË, TRAJNIM I EKIPIT TË ILD-SË

Gjatë dy ditëve të trajnimit katër inspektore magjistrate, Delphine Agoguet and Sylvie Merges, nga Inspektoriati i Lartë të Drejtësisë, Francë; Emanuela Aliverti nga Inspektoriati i Drejtësisë, Itali dhe Nicoleta Rfhir nga Inspektoriati i Drejtësisë, Rumani kanë prezantuar dy module pune, mbi parimet e Inspektimit të përgjithshëm dhe metodologjinë e instrumentet e Inspektimit, procedurat dhe raportet.

Ekipi i Inspektorëve, ndihmës Inspektorëve dhe kabineti i zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përfundoi trajnimin dy ditor me temë: “Inspektimet gjyqësore, praktika të mira nga Inspektoriatet Europiane të Drejtësisë”.

Në ditën e parë të trajnimit u diskutua mbi misionet klasike të inspektimit, statusi dhe etika e inspektorëve, parimet dhe metodat e inspektimit, standardet evropiane dhe ndërkombëtare të inspektimeve.

Në fjalën e tij përshëndetëse në nisje të trajnimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani, duke vlerësuar organizimin tha se inspektimi sot kërkon një mentalitet të ri dhe se çdo eksperiencë i shërben punës së gjithsecilit.

Në ditën e dytë u diskutua me raste konkrete mbi inspektimin e gjykatave dhe prokurorive, menaxhimin e këtij procesi, instrumentet në dispozicion dhe mbështetjen institucionale, të ilustruara me raste studimore të praktikës së mirë.

Koordinatori i CEPEJ Roland Gjoni prezantoi rolin e projektit SEJ III dhe qëllimin e trajnimit, ndërsa koordinatoreja e programeve të bashkëpunimit të Rrjetit Europian të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), Delphine Agoguet, gjithashtu Inspektore e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, foli mbi rritjen e kapaciteteve profesionale përmes Rrjetit RESIJ dhe bashkëpunimin e nisur nga ky rrjet me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë së Shqipërisë.

Trajnimi i organizuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e Këshillit të Evropës SEJ III është nisja e një bashkëpunimi me Rrjetin Europian të Inspektimit, përmes anëtarëve, nga vende të Bashkimit Europian. Në rastin konkret përmes ekspertëve, si dhe drejtuesve të institucioneve të Inspektimit nga Rumania, Portugalia e Franca, që zhvilluan një vizitë pune treditore në Shqipëri.



INSPEKTORI I LARTË METANI DHE INSPEKTORËT EUROPIANË TË DREJTËSISË VIZITË NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani dhe inspektorët homologë, kreu i Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë z. Lucian Netejoru, znj. Martine Bardet nga Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë së Francës dhe z. Luis Jardim nga Inspektorati i Drejtësisë në Portugali zhvilluan një takim në Kuvendin e Shqipërisë, ku u pritën nga zv.kryetarja e Kuvendit znj. Ermonela Felaj dhe kryetarja e komisionit të ligjeve znj. Klotilda Bushka. Znj.Felaj dhe znj.Bushka bënë një prezantim të reformës në drejtësi dhe rolit të institucioneve të reja të ngritura prej saj. Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, zv.kryetarja e Kuvendit tha se “Inspektori Metani po e sheh punën, jo vetëm si sfidë profesionale por edhe personale sepse në një kohë të shkurtër i është dashur të përballlet me vështirësi me impakt të lartë dhe nuk ka qenë e lehtë.”

Kryetarja e komisionit të ligjeve tha se Kuvendi i Shqipërisë mbështet nevojat e institucioneve të drejtësisë, përfshi ILD-në për funksionimin sa më të mirë, e në mënyrë të pavarur të tyre. “Fakti që raportojnë në Kuvend, nuk është aspak ndërhyrje në pavarësinë e tyre”, tha znj. Bushka.

Znj. Bardet tha se Inspektorati i Përgjithshëm i Drejtësisë së Francës, që kryeson Rrjetin Europian të Shërbimeve të Inspektimit, pjesë e të cilit janë edhe kolegët e saj që po vizitojnë Shqipërinë, evidentoi se standardet dhe eksperiencat e këtij Rrjeti janë gati t’i ndajnë me Shqipërinë dhe kjo ka filluar me trajnimin dy ditor që po zhvillojnë 4 inspektorë francezë, italianë e rumunë me ekipin e inspektorëve e ndihmës inspektorëve të zyrës së ILD-së. Duke folur për eksperiencën e Rumanisë, me një Inspektim Gjyqësor krejt të pavarur, gjykatësi Netejoru tha se misioni i inspektimeve



është që t’i shërbejë gjyqësorit për të përmirësuar aktivitetin e tij e për t’i dhënë një drejtësi të besueshme publikut.

Ndërsa inspektori-gjyqtar Jardim evidentoi se ka ngjashmëri mes Shqipërisë e Portugalisë, sa i takon rekrutimit të inspektorëve magjistratë me cilësi të larta profesionale e juridike dhe vlerësoi punën e bërë nga Inspektori i Lartë Metani. “Përpjekja e mrekullueshme që po bën z.Metani bashkë me inspektorët e tjerë, mbase tani do keqkuptohet, por në një të ardhme të afërt koha do u japë të drejtë.”, tha z.Jardim.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani vlerësoi bashkëpunimin e vendosur me kolegët europianë në kuadër të Rrjetit Europian të Shërbimeve të Inspektimit e angazhimit të projektit SEJ III të Këshillit të Evropës, që po mbështet zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në fuqizimin e kapaciteteve profesionale.





Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani ka shoqëruar homologët e tij evropianë, kreun e Inspektimit Gjyqësor të Rumanisë Lucian Netejoru, inspektorin Luis Jardim nga Inspektorati i Drejtësisë së Portugalisë dhe inspektoren Martine Bardet nga Inspektorati i

INSPEKTORI I LARTË METANI DHE HOMOLOGËT E TIJ EUROPIANË VIZITË NË GJYKATËN E RRETHIT VLORË

Përgjithshëm i Drejtësisë së Francës, në një vizitë pune në gjykatën e rrethit Vlorë.

Zv. Kryetari i Gjykatës z.Enkel Peza i është përgjigjur interesit të Inspektorëve evropianë mbi mënyrën e funksionimit të gjykatës, funksionimit të saj me gjysmë kapaciteti për shkak të largimeve të gjyqtarëve nga sistemi, si dhe masat e marra për të asistuar gjyqtarët në detyrë për të përballuar numrin e lartë të çështjeve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani tha se ky është një problem edhe për gjykata të tjera, por puna vijon edhe në kushtet e mbingarkesës.

NJË VLERËSIM ANALITIK I ECURISË SË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË, DO I BËNTE TË PREKSHME TË SHKUARËN DHE TË QARTË TË ARDHMEN



Gjatë një vizite pune në Bruksel, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani mori pjesë në aktivitetin *“Qeverisja e mirë dhe qëndrueshmëria e institucioneve të drejtësisë në Ballkanin Perëndimor”*, ku merrte pjesë edhe ministri i Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, Bojan Maričić, në kuadër të sfidave që dy vendet kanë, në pritje të hapjes së negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Aktiviteti u organizua nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim (CDI) dhe Qendra për Studime të Politikave Evropiane me qendër në Bruksel (CEPS), me mbështetjen e Mbretërisë së Holandës dhe më pjesëmarrjen online të organizatave të shoqërisë civile.

Duke paraqitur eksperiencën e Shqipërisë, gjatë fjalës së tij *“Vështrime dhe mësimet e nxjerra nga zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, z. Metani tha ndër të tjera, se reforma në drejtësi në Shqipëri është një nga reformat më të thella ligjore dhe institucionale në raport me vendet e tjera të Ballkanit perëndimor. Reforma në drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Institucionet e sistemit të drejtësisë janë ngritur, si dhe janë angazhuar plotësisht për të dhënë rezultate konkrete në punën e tyre. Shqipëria mund të konsiderohet si kryesuese e këtij procesi dhe përvoja e saj mund të ndihmojë për proceset planifikuese, zbatimin apo monitorimin e reformave me karakter institucional në vendet e tjera të Ballkanit perëndimor.

Gjatë prezantimit të raportit të monitorimit të institucioneve të reja të drejtësisë në Shqipëri, bashkautorët, drejtori i kërkimeve në CDI, Ardian Haçkaj dhe ekspertja e lartë Fjoralba Caka, vlerësuan rëndësinë e organizmit dhe funksionimit të organeve të reja të drejtësisë, nëpërmjet një procesi legjitim. Ky proces është një faktor i rëndësishëm për organizmin dhe funksionimin e institucioneve të reja të drejtësisë në mënyrë sa më të qëndrueshme, në përputhje me parimin

e



mirëqeverisjes, si dhe në raport me pritshmëritë e qytetarëve shqiptarë dhe të partnerëve ndërkombëtarë.

Bashkautorët e raportit theksuan rëndësinë e proceseve të brendshme, të cilat duhen ndjekur nga ana e institucioneve të reja të drejtësisë në kuadër të efektivitetit, përgjegjshmërisë, apo transparencës së veprimtarisë së tyre. Këto procese duhet të shërbejnë për sigurimin e aksesit të qytetarëve, si dhe rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

Znj. Caka tha se: “Statistikat e zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë tregojnë qartë që qytetarët janë të gatshëm të bashkëpunojnë dhe kanë besim tek institucionet. Komunikimi aktiv ndërmjet qytetareve dhe zyrës së ILD, si dhe numri ankesave, janë tregues mbi aplikimin e modeleve të mira të transparencës dhe ekzistencën e besimit të tyre ndaj veprimtarisë së institucioneve.”

Gjatë sesionit që u moderua nga drejtori i CEPS Steven Blockmans, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani theksoi në veçanti se:

Së pari: Reforma në drejtësi në Shqipëri po vijon prej disa vitesh. Megjithatë, aktualisht akoma nuk kemi një fotografim të qartë lidhur veprimtarinë e institucioneve të reja të drejtësisë për të arritur në një përfundim të përbashkët mbi “performancën e mirë” ose “performancën jo të mirë” të institucioneve të reja. Ky proces duhet të realizohet nëpërmjet një metodologjie të mirë përcaktuar dhe mbështetur në indikatorë apo tregues me karakter sasior apo cilësor.

Së dyti: Reforma në drejtësi në Shqipëri ka qenë shumë e thellë dhe për të qenë i sigurtë, edhe traumatike për shoqërinë shqiptare. Me këtë nuk dua aspak të them, se nuk ishte diçka e mirë. Përkundrazi, kjo reformë ishte gjëja më e mirë për vendin tonë. Por duhet t'a vlerësojmë këtë sakrificë që bëri shoqëria shqiptare duke e mbështetur atë. Personalisht, dhe këtu ndahem nga mendimi i kolegëve në këtë tryezë, – nuk kam asnjë dyshim se reforma në drejtësi do jetë një sukses. Pavarësisht kohës që duhet për zbatimin e saj. Natyrisht askush

apo edhe vetë Bashkimi Evropian, nuk mund të ketë pritshmëri se reforma do ketë sukses në dy apo tre vitet e ardhshëm. Reforma do jetë efektive të paktën pas një dekade, si dhe procesi i vlerësimit të reformës në drejtësi duhet të jetë një proces me rregulla të mirëpërcaktuara dhe paraprakisht.

Së treti, për të pasur një reformë të suksesshme në drejtësi, ajo nuk duhet ndarë nga dimensionet apo zhvillimet e tjera të shoqërisë. Duhet demokratizuar e gjithë shoqëria në Shqipëri dhe mënyra më e mirë për t'a bërë këtë është përmes procesit të integritit. Ky proces nuk mund të bëhet vetëm me takime on-line, por edhe me trajnime, takime të drejtpërdrejta, shkëmbime eksperiencash, si dhe praktika apo kultura pune të BE. Dhe me këtë shkoj tek ideja, se mbase etapat e BE-së janë të gjata, por ne mund të shkojmë në një rrugë tjetër, siç e quajti Ardiani “lidhja ndërinstitucionale”. Sa më shumë kontakte të kenë institucionet në Shqipëri me homologët e tyre apo partnerë të tjerë në vendet e BE-së e strukturat e tyre, aq më mirë do të jetë për vetë reformën, por edhe për zhvillimin e vendit.

Ndërhyrja e dytë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani

Z. Metani: “Reforma në drejtësi në Shqipëri është mbase një nga reformat që mori mbështetjen më të madhe të publikut. Pra jo vetëm për 140 votat në kuvend, në unanimitet të plotë të të gjithë deputetëve, por edhe me mbështetjen e shoqërisë shqiptare sepse ajo e ndjente nevojën për ndryshim e për reformën në drejtësi dhe ajo shpresë, ajo ndjesi është ende e pranishme në shoqërinë shqiptare, por po zëvendësohet nga zhgënjimi, për shkak të vonësive në ngritjen e institucioneve tona e për shkak të problemeve të reformës, të efekteve normale që ka prodhuar. Por dua edhe të nënvizoj nevojën se ne duhet të jemi të pranishëm përmes publikimit të aktiviteteve tona, për të qenë transparentë për punën tonë, por gjithashtu – dhe unë insistoj tek fakti që metodologjia që duhet të ndiqet nga BE, duhet të mbështetet në tregues të qartë, sepse njerëzit kanë nevojë të dinë, se si po punojnë institucionet e drejtësisë në Shqipëri dhe si po perceptohet puna e tyre nga ana e BE. Ja pse unë insistoj se ky proces duhet vlerësuar hap pas hapi, duke i dhënë meritë procesit dhe gjithashtu duke krijuar standarde të reja për të ardhmen, në mënyrë që të rrisim shpresat e shoqërisë dhe të përmbushim pritshmëritë e saj.”

METANI: KOHA PËR TË RRRITUR EFIKASITETIN E MARRË MASAT, QË REFORMA NË DREJTËSI TË JAPË REZULTATET PËR TË CILAT U KONCEPTUA

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani në Bruksel me temë: “Fillimi punës: Vështrime dhe mësimë të nxjerra nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.”



Faleminderit për ftesën dhe mundësinë për të ndarë në këtë takim eksperiencën time personale, në cilësinë e drejtuesit të njërit prej institucioneve më të reja, të konceptuara dhe të ngritura në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

Njëkohësisht nëpërmjet fjalës sime do të shpreh edhe disa konsiderata, apo ndjesi personale, me të cilat jam përballur gjatë këtij procesi, por jo vetëm në optikën e një profesionisti të së drejtës, por edhe si një qytetar shqiptar, që besoj thellësisht në vlerat themelore të Bashkimit Evropian.

Në kuadër të proceseve integruese të vendit, në Shqipëri është duke u zbatuar reforma në drejtësi. Kjo reformë ka për qëllim ngritjen e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit.

Reforma në drejtësi lindi si nevojë për ndryshim. Një ndryshim i cili në frymën e vlerave të Bashkimit Evropian ka si qëllim vendosjen e një ekuilibri të drejtë midis pushtetit, demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Është një nga reformat më të thella ligjore dhe institucionale. Modeli i përzgjedhur dhe shkalla e ndërhyrjes në sistemin e drejtësisë në Shqipëri përfaqëson një rast unik. Institucionet e reja janë krijuar ose riorganizuar dhe në raport me vendet e tjera të Ballkanit perëndimor, Shqipëria

mund të konsiderohet si kryesuese e këtij procesi reformues. Në këtë kuadër, përvoja e Shqipërisë me reformën në sektorin e drejtësisë mund të ndihmojë për proceset planifikuese, zbatimin apo monitorimin e reformave me karakter institucional në vendet e Ballkanit perëndimor.

Megjithatë, në rastin konkret duhet të mbahet në konsideratë fakti se shtetet e Ballkanit perëndimor janë në faza të ndryshme të procesit integrues të tyre. Gjithashtu shtetet kanë sisteme dhe tradita të ndryshme ligjore. Pavarësisht se koncepti i shtetit apo sundimit të ligjit është i njëjtë për të gjitha vendet e BE, kërkohet që aplikimi i këtyre standardeve të bëhet në respekt të plotë të traditave dhe kontekstit politik, social apo ligjor të një vendi. Ky proces duhet të realizohet përmes një analize të kujdesshme, lidhur me modelin e përzgjedhur dhe shkallën e ndërhyrjes në sistemin e drejtësisë. Duhet të realizohet gjithashtu, nëpërmjet një procesi shkëmbimi eksperiencash për të adresuar sfidat, si dhe për të mësuar nga përvoja e vendeve të tjera.

Sic e thashë, Reforma në Drejtësi është në fazën e zbatimit të saj. Megjithatë ky proces nuk ka qenë i lehtë. Reforma tërësore e sistemit të drejtësisë është përballur me disa sfida në ngritjen dhe fillimin e funksionimit të organeve të reja, të cilat kanë pasur një ndikim tepër të rëndësishëm gjatë veprimtarisë fillestare të këtyre institucioneve, si: (i) Ekzistenca e një vullneti politik fillestar për miratimin e saj, si dhe ndryshimi i këtij vullneti gjatë zbatimit të saj; (ii) vonesa në ngritjen e institucioneve të reja dhe në përzgjedhjen e anëtarëve të tyre; (iii) mungesa e infrastrukturës dhe burimeve njerëzore; (iv) mungesa e planifikimit dhe mbështetjes buxhetore; (v) mungesa e magjistratëve si pasojë e procesit të vettingut; (vi) mungesa e një strategjie bashkëveprimi ndër-institucional; (vii) ekzistenca e pengesave teknike apo administrative për ushtrimin e kompetencave në mënyrë të plotë nga ana e institucioneve; (ix) apo tjetër. Faktorët në nivel politik apo organizativ, të cilët mund të kenë sjellë këto vonesa mund të jenë të ndryshëm. Për sa është analizuar nga ana e Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim në studimin “Qëndrueshmëria e Reformës në Drejtësi në Shqipëri” ata mund të konsistojnë në disa drejtime si: (i) konceptimi i

kësaj reforme jo në bazë të metodës së “hulumtimit vlerësues” , por sipas metodës së “zgjidhjes së problemeve”; (ii) ekzistenca e vizionit, vlerave apo vullnetit politik; (iii) kompetencat kryesore, infrastruktura bazë, njohuritë e ngulitura, burimet teknike dhe financiare; apo (iv) qëndrueshmëria, proceset e të nxënit dhe forca e partnerëve.

Megjithatë, tashmë pjesa më e madhe e këtyre pengesave është kaluar dhe organet e reja funksionojnë në mënyrë të plotë. Reforma në Drejtësi ka hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të zbatimit të saj. Institucionet e sistemit të drejtësisë janë angazhuar plotësisht për të krijuar një sistem në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, si dhe për të dhënë rezultate konkrete në punën e tyre. Tashmë sfida e vendit tonë, si dhe suksesi i zbatimit të reformës në drejtësi nuk është më konceptimi dhe ngritja e organeve të reja të sistemit të drejtësisë, por funksionimi i tyre në bazë të parimit të mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës.

Institucionet e reja të sistemit të drejtësisë nuk janë automatikisht funksionale dhe në përputhje me standardet mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës. Koncepti i shtetit të së drejtës është një koncept kompleks, që bën dallim ndërmjet ekzistencës formale të parashikimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë. Në rastin konkret, reforma në drejtësi ka ngritur kapacitetet e sistemit të drejtësisë, por arritja e rezultateve konkrete kërkon ndikim dhe ndryshim në kulturën gjyqësore dhe politike të një vendi. Ndërsa kapacitetet e sistemit të drejtësisë rriten, rezultatet duhet tregojnë ndryshim.

Bashkimi Evropian bazohet në një sërë vlerash të përbashkëta, të cilat përfshijnë respektimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Këto vlera themelore përbejnë një aset kryesor për Bashkimin Evropian dhe ruajtja apo sigurimi i tyre përbën një përgjegjësi të përbashkët për të gjitha institucionet e BE-së, si dhe shtetet anëtare të tij. Duhet thënë se Bashkimi Evropian ka luajtur një rol kyç në hartimin, financimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi. Ndikimi i BE-së ka shërbyer si një si një stimul i jashtëm, për të ndikuar një proces ndryshimi brenda vendit tonë. Por njëkohësisht ndryshimi i brendshëm mund të arrihet vetëm nga shtetasit e atij vendi.

Bashkimi Evropian si dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së sistemit të drejtësisë nga pikëpamja formale, por ky proces duhet të

shoqërohet njëkohësisht edhe me përpjekje të vazhdueshme nga ana e shtetit dhe qytetarëve shqiptarë për zbatimin e këtyre rregullave dhe si rrjedhim për të arritur një cilësi në praktikë, të sistemit të drejtësisë. Kjo nënkupton që në rastin konkret ka nevojë jo vetëm për një “iniciativë pasive”, e cila materializohet nëpërmjet një procesi legjislativ, por për një “aktivizim politik energjik dhe të vazhdueshëm” në drejtime të ndryshme, të gjitha me një qëllim të vetëm: krijimin e shtetit të së drejtës.

Bashkimi Evropian mund të sjellë ndryshime dhe të ndikojë në cilësinë e reformimit të sistemit të drejtësisë në mënyrë indirekte. Ndikimi i BE mund të ndikojë mbi mënyrën dhe zbatimin e një procesi reformues, nëpërmjet strategjisë së kushtëzimit demokratik (në lidhje me kriteret politike të Kopenhagenit), apo kushtëzimit lidhur me acquis communautaire. Ky proces duhet të jetë sa politik aq edhe meritokratik.

Nga ana tjetër, BE nëpërmjet “fuqisë së saj transformuese”, duke përhapur vlerat demokratike tek qytetarët dhe duke përkrahur elitat politike, të cilat besojnë dhe punojnë për vlerat e Bashkimit Evropian, mund të vendosë një ekuilibër të drejtë ndërmjet pushtetit , demokracisë liberale, si dhe shtetit të së drejtës. Bashkimi Evropian, duhet të vijojë të ofrojë asistencë teknike, sic ka operuar që nga viti 2005, edhe ndërmjet Misionit Euralius, apo formave të tjera të asistencës teknike. Unioni mund të ndihmojë në implementimin e reformës në drejtësi nëpërmjet udhëzimeve, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve institucionale, apo një sërë dimensionesh të tjera, të cilat do të bënin të mundur zbatimin në praktikë të saj. Shqipëria ka treguar se është në reformim të vazhdueshëm për të vendosur stabilitet dhe garanci demokratike. Por rruga drejt krijimit të institucioneve funksionale, standardeve demokratike dhe shtetit të së drejtës nuk është e lehtë. Megjithatë, shpejtësia me të cilën po zbatohet kjo reformë dhe mjedisi politik ku po zhvillohet janë dy nga treguesit kryesorë, mbi mënyrën e zbatimit të saj.

Zbatimi i reformës në drejtësi është një proces që vazhdon. Kjo reformë është një detyrim i shtetit shqiptar ndaj qytetarëve të tij. Ky nuk është momenti për të rihapur diskutimin mbi nevojën e reformës në drejtësi, pasi domosdoshmëria e saj tashmë është një fakt tashmë i provuar. Tani është koha për të rritur efikasitetin e saj, si dhe për të marrë masat, që kjo reformë të japë rezultatet për të cilat u konceptua.

Faleminderit!



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË PRITI NJË DELEGACION ME PËRFAQËSUES TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË NGA ARMENIA

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani priti një delegacion nga Armenia, në përbërje të të cilit ishin anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, të Komisionit për Parandalimin e Korrupsionit, të ministrisë së drejtësisë e të zyrës së BE-së.

Delegacioni armen po zhvillon një vizitë pune në Shqipëri për t'u njohur me zbatimin e reformës në drejtësi dhe mënyrën e funksionimit të institucioneve të drejtësisë.

Inspektori i Lartë Metani i njohu anëtarët e delegacionit armen me funksionet dhe detyrat e zyrës së ILD-së dhe iu përgjigj pyetjeve të tyre mbi procedurat e punës sa i takon ankesave, hetimit e procedimit disiplinor të magjistratëve në vend.



Nëntor 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



KONTAKT ILD


WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)

 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/Inspektori%20i%20Lart%C3%AB%20i%20Drejt%C3%ABs%C3%ABs%C3%AB)



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com/ILD_Albania)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)